

NJOFTIM
Nr. 185, datë 16.5.2019

**PËR SHPALLJEN E NJË VENDI TË LIRË PUNE PRANË GJYKATËS SË RRETHIT
GJYQËSOR LUSHNJE**

Në zbatim të ligjit nr. 98/2016, datë 6.10.2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor dhe të Kodit të Punës” shpall konkursin për një vend të lirë pune në pozicionin:

Punonjës IT dhe Marrëdhënie me Publikun

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati janë:

1. Të ketë mbaruar arsimin e lartë (Diplomë në teknologji informacioni, shkencë kompjuterike, inxhinieri kompjuterike) të paktën në nivel master shkencor ose të barasvlefshëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë.

2. Të ketë kryer të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.

3. Të ketë aftësi të mira komunikuese.

4. Eksperienca në punë përbën avantazh.

5. Nota mesatare përbën avantazh.

Dokumenti i nevojshëm që duhet të paraqesi kandidati:

Kandidati duhet të paraqesë pranë institucionit këto dokumente:

1. Kërkesa e kandidatit drejtuar institucionit.

2. Jetëshkrimi i kandidatit (C.V).

3. Diploma Universitare me listën e notave (kopje e noterizuar).

4. Fotokopje e kartës së identitetit, certifikatë personale me fotografi.

5. Libreza e punës.

6. Vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata se nuk është në procedim hetimor dhe gjyqësor.

7. Vërtetim i gjendjes gjyqësore, (vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji).

8. Vërtetim vendbanimi.

9. Dëshmi të tjera kualifikimi nëse ka.

10. Vërtetim të lëshuar nga KML-ja.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë në origjinal ose të noterizuara dhe të kenë afat jo më shumë se tre muaj nga data e lëshimit deri në datën e pranimit. Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërm përbën kusht për skualifikim.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është deri në datën **14.6.2019**.

Konkursi do të zhvillohet në datën **17.6.2019**, ora **09:00**.

KRYETARE E GJYKATËS
Esmeralda Xhili (Çeka)